



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.259/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi- Referues, Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: “Con Des” SH.P.K, NNP “Euro Construction” dhe “Jetmiri” SH.P.K- Prishtinë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “AC Ing” SH.P.K “AAG Projekt” SH.P.K – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i qendrës kulturore për të rinjë - Bibliotekës në lagjen Kodra e Trimave” me nr. të prok: 616-19-9417-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/”Kuvendi Komunal Prishtinë”, më datën: 11.06.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Con Des“ SH.P.K, NNP “Euro Construction” dhe “Jetmiri” SH.P.K-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i qendrës kulturore për të rinjë-Bibliotekës në lagjen Kodra e Trimave” me nr. të prok: 616-19-9417-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/”Kuvendi Komunal Prishtinë”.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i qendrës kulturore për të rinjë-Bibliotekës në lagjen Kodra e Trimave” me nr. të prok: 616-19-9417-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/”Kuvendi Komunal Prishtinë” dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Con Des” SH.P.K, NNP “Euro Construction” dhe “Jetmiri” SH.P.K-Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE: “Con Des” SH.P.K, NNP “Euro Construction” dhe “Jetmiri” SH.P.K-Prishtinë si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 21.04.2020 me nr. 259/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i qendrës kulturore për të rinjë - Bibliotekës në lagjen Kodra e Trimave” me nr. të prok: 616-19-9417-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/”Kuvendi Komunal Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 59, 60, 64 si dhe nenin 69,72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 22.04.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 29.04.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimin nr 1.

Eksperti shqyrtues konstaton se përgjigja lidhur me pretendimin e grupit të OE ankues “Con-Des” SH.P.K, NNP “Euro Construction” dhe “Jetmiri” SH.P.K- Prishtinë, se AK gjatë fazës së vlerësimit të ofertave ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin se nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme se ka përfunduar kontrata për ndërtim të objekteve të ndërtimit të lartë në 3(tri) vitet e fundit në vlerë minimale prej 800,000.00 €,ku sipas pretendimit të OE ankues kontratat dhe referencat e dorëzuara nga ky konzorcium e tejkalojnë vlerën e kërkuar prej 800,000.00 €, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë tek kërkesa 1. e kapacitetit teknik dhe profesional nga OE



është kërkuar të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar kontrata për ndërtim të objekteve të ndërtimit të lartë në 3(tri)vitet e fundit(duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 800,000.00 €, duke dëshmuar me një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.

Në ofertën e tyre të dorëzuar, grupi i OE: “Con-Des” SH.P.K; NNP” Euro Construction” dhe ”Jetmiri” SH.P.K – konform Aneksit 6 të Dosjes së Tenderit ka dorëzuar listën e kontratave të realizuara për dy anëtar të konzorciumit duke e dëshmuar me referenca apo certifikata për kryerjen e punëve. Më poshtë po i listoj disa nga kontratat/referencat të cilat sipas mendimit të ekspertit shqyrtues përmbushin kërkesën e Dosjes së Tenderit.

1.Kontrata në mes të OE: NNP ”Euro Construction” dhe “Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës” e lidhur me 01.06.2018 në vlerë prej 159,817.65€ për “Ndërtimin e Aneksit të kuzhinës në Kazermën e FSK-së në Prishtinë me nr. prokurimi 217-18-1893-5-2-1,e dëshmuar me raport për pranim teknik me datë 21.12.2018. Gjithashtu, për këtë kontratë ka pasur edhe një aneks kontratë në vlerë prej 14,219.89 €. Kjo kontratë përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit.

2. Kontrata në mes të OE NNP “Euro Construction” dhe “Ministrisë së punëve të Brendshme” e lidhur me 15.08.2015 në vlerë prej 309,155.18€ për “Ndërtimin e objektit të QKRC-QKRA-së në Istog” me nr. prokurimi 214-15-013-5-1-1,e dëshmuar me raport të pranimit teknik të datës 14.12.2017.Gjithashtu për këtë kontratë ka pasur edhe një aneks kontratë në vlerë prej 6,369.46 € të cilat janë konform kërkesës së dosjes së tenderit.

3. Kontrata në mes të OE: NNP “Euro Construction” dhe “Kuvendit Komunal të Prishtinës” e lidhur me 20.07.2018 në vlerë prej 69,659.90 € për ‘Rikonstruksioni, gëlqerosja, mirëmbajtja e nyjeve sanitare dhe rikonstruksioni i dysHEMEVE në Institucionet Arsimore Llot II” me nr. prokurimi 616-18-022-5-2-1, e dëshmuar me konstatim për kryerjen të punëve nga AK me datë 01.07.2019 në vlerë prej 90,471.27€(69,659.90 +/- 30% - max 90,557.87 €). Për ekspertin shqyrtues kjo kontratë për punën e investimeve kapitale është e ngjashme me punët që do të kryhen në këtë procedurë të prokurimit dhe është konform kërkesës së dosjes së tenderit.

4. Kontrata në mes të OE: NNP “Euro Construction” dhe “Kuvendit Komunal të Prishtinës” e lidhur me 19.04.2016 në vlerë prej 349,989.00 € me mundësi +30% për “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e nyjeve sanitare” me nr. prokurimi 616-16-023-5-2-1, e dëshmuar me raport përfundimtar për realizimin e punëve nga AK me datë 13.07.2018 në vlerë prej 447,887.71,471 €. Për ekspertin shqyrtues kjo kontratë për punë e investimeve kapitale është e ngjashme me punët që do të kryhen në këtë procedurë të prokurimit dhe është konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Gjithashtu grupi i OE ka dorëzuar edhe disa kontrata në emër të anëtarit tjetër të konzorciumit "Jetmiri" SH.P.K të cilat janë pranuar nga ana AK-së gjatë vlerësimit të ofertës të pasqyruar edhe në vendimin e AK-së mbi kërkesën për rishqyrtim të grupit të OE: "Con-Des" SH.P.K, NNP "Euro Construction" dhe "Jetmiri" SH.P.K - Prishtinë.

Në bazë të kontratave të prezantuara, eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues përmbush kërkesën 1. të kapacitetit teknik dhe profesional ku është kërkuar që OE duhet të ofrojë kontrata të realizuara minimum 800,000.00 € në tri vitet e fundit. Vlera e këtyre kontratave të prezantuara e tejkalon shumë prej 800,000.00 €.

Në vendimin e AK për kërkesën për rishqyrtim të datës 10.04.2020, AK ka pranuar disa kontrata / referenca siç janë kontratat e listuara më lartë me nr.1 dhe 2 dhe disa kontrata tjera të anëtarit të konzorciumit "Jetmiri" SH.P.K, që kanë të bëjnë me rregullimin e rrethojës në Kampusin Univeritar në Mitrovicë, ndërtimi (renovimi) i lapidarit të familjes Rama, ndërtimi i lapidarëve përkujtitor dhe mirëmbajtja e tyre, që në total këto projekte kanë një vlerë prej 111,858.88 €, ndërsa kontratat e listuara më lartë me nr. 3 dhe 4 nuk janë pranuar nga AK si kontrata që përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit. Për ekspertin shqyrtues është e paqartë sesi AK gjatë vlerësimit të ofertës ka pranuar kontratat që kanë të bëjnë me ndërtimin apo edhe mirëmbajtjen e lapidarëve e nuk ka pranuar dy kontrata të lidhura me AK-Komuna e Prishtinës që janë kontrata kapitale-punë që lidhen me rikonstrukcionin dhe mirëmbajtjen kapitale të institucioneve arsimore.

Sa i përket kontratës në mes të OE :NNP "Euro Construction" dhe "Komunës së Pejës" për ndërtimin e shkollës fillore të mesme të ulët në fshatin Leshan, e lidhur me datë 08.05.2018 në vlerë prej 315,153.53€, e cila është realizuar me datë 23.12.2019 (sipas raportit të pranimit teknik), kjo kontratë nuk është pranuar nga AK me arsyetimin së realizimi i kësaj kontrate është bërë pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë (09.12.2019), eksperti shqyrtues sqaron se AK duhet të kishte parasysh se oferta e OE ankues është me çmim më të lirë dhe se kontrata është realizuar para datës së hapjes së ofertave.

Gjithsesi edhe pa këtë kontratë, vlera e kontratave tjera e tejkalon shumë prej 800,000.00€ e kërkuar sipas dosjes së tenderit. Konsideroj që pretendimi ankimor është i bazuar

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 30.04.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.



Operatori Ekonomik, me datë: 29.04.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Pretendim ankimor i operatorit ekonomik ankues "Con Des" SH.P.K, NNP "Euro Construction" dhe "Jetmiri" SH.P.K-Prishtinë, është se AK gjatë fazës së vlerësimit të ofertave pa të drejtë e ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin se nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme se ka përfunduar kontrata për ndërtim të objekteve të ndërtimit të lartë në 3(tri) vitet e fundit në vlerë minimale prej 800,000.00€, sepse sipas pretendimit të OE ankues kontratat dhe referencat e dorëzuara nga ky konzorcium e tejkalojnë vlerën e kërkuar prej 800,000.00 €.

Paneli Shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, tek kërkesa 1. e kapacitetit teknik dhe profesional nga OE është kërkuar të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar kontrata për ndërtim të objekteve të ndërtimit të lartë në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 800,000.00 €, duke dëshmuar me një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.

Paneli Shqyrtues sqaron se OE ankues "Con-Des" SH.P.K; NNP "Euro Construction" dhe "Jetmiri" SH.P.K – konform Aneksit 6 të Dosjes së Tenderit ka dorëzuar listën e kontratave të realizuara për dy anëtar të konzorciumit duke e dëshmuar me referenca apo certifikata për kryerjen e punëve.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e ekspertit shqyrtues konstaton se AK-ja i ka pranuar konzorciumit ankues vlerën e kontratave prej 601,421.06 euro.

Në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim të dt.10.04.2020 autoriteti kontraktues i ka analizuar kontratat dhe ia ka marr parasysht OE ankues kontratat si në vijim:

1.Ndërtimi i aneksit të kuzhinës në FSK në vlerë prej 159,817.65 euro dhe aneks kontrata për të njëjtën në vlerë prej 14,219.65 euro; 2.Ndërtimi i objektit të QKRS-QKRA në Istog në vlerë prej 309,155.18 euro

dhe aneksi ne vlere prej 6,369.46 euro. Për “Jetmiri: 1.Rregullimi i rrethojës ne Kampusin Universitar ne Mitrovice ne vlere prej 26,367.60 euro; 2.Ndertimi(renovimi)i lapidarit te familjes Rama ne vlere prej 19,531.25 euro; 3.Ndertimi i murit mbrojtës ne Breshanse dhe Stravaqine ne vlere prej 16,019.00 euro; 4.Ndertimi i lapidareve përkujtimor dhe mirëmbajtja ne vlere prej 49,941.03 euro. Pra si valide autoriteti kontraktues i ka konsideruar dëshmitë dhe referencat me procesverbale të pranimeve teknike në vlerë prej: 489,562.18 për anëtarin e konzorciumit “Euroconstruction” dhe vlerën prej: 111,858.88 për anëtarin e konzorciumit “Jetmiri”, e që në total mbërrijnë vlerën 601,421.06 euro.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha dëshmitë e prezantuara nga palët, sqaron se autoriteti kontraktues nuk e ka marr parasysh kontratën në mes të OE NNP “Euro Construction” dhe “Komunës së Pejës” për ndërtimin e shkollës fillore të mesme të ulët në fshatin Leshan, e lidhur me datë 08.05.2018 në vlerë prej 315,153.53€, ku figuron se pranimi teknik është bërë me datë 23.12.2019 (sipas raportit të pranimit teknik), me arsyetimin së realizimi i kësaj kontrate është bërë pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë (09.12.2019). Paneli Shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, tek kërkesa 1. e kapacitetit teknik dhe profesional nga OE është kërkuar të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar kontrata për ndërtim të objekteve të ndërtimit të lartë në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 800,000.00 €.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës, si dhe duke u bazuar në konstatimet e ekspertit shqyrtues, i cili ka konstatuar se konzorciumi ankues e plotëson kërkesën në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional konkretisht dëshmitë në lidhje me referencat-procesverbalet e pranimeve teknike dhe listën e kontratave në vlerë 800, 000.00 euro, edhe pa llogaritur vlerën e kësaj kontratë, vjen në përfundim se OE ankues është eliminuar padrejtësisht sepse i njëjti e ka plotësuar kërkesën në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional konkretisht dëshmitë në lidhje me referencat-procesverbalet e pranimeve teknike dhe listën e kontratave në vlerë 800, 000.00 euro dhe se AK duhet të kishte parasysh se oferta e OE ankues është me çmim më të lirë dhe se kontrata është realizuar para datës së hapjes së ofertave, e cila nuk ndikon absolutisht në gjendjen materiale apo në substancë. Prandaj kjo kontratë për punë, e investimeve kapitale është e ngjashme me punët që do të kryhen në këtë procedurë të prokurimit dhe është konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha dëshmitë, faktet, argumentet dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, Nëse Autoriteti Kontraktues ka dilema lidhur me këto dëshmi mund ti sqaroj konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së.



Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu autoritet kontraktues duhet të kenë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK- "Kuvendi Komunal Prishtinë",

1x1 "Con Des" SH.P.K: NNP "Euro Construction" dhe "Jetmiri" SH.P.K-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.